

AKTUALITETKRYESORETË FUNDIT

U plagos me armë zjarri dhe deklaroi se ishte dëmtuar me hekur, në pranga 35-vjeçari dhe dy shokët e tij

🕒 31/12/2022 16:49



Një 35-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Elbasanit, pasi ka shkuar në spital i plagosur me armë zjarri dhe ka gënjyer policinë.

Në pranga ranë edhe dy shokët e tij për moskallëzim krimi. Të arrestuarit janë F. M., 35 vjeç, Sh. H., 33 vjeç dhe M. G., 30 vjeç, të tre banues në lagjen “5 Maji”, Elbasan të cilët akuzohen për veprat penale “Moskallëzimi krimi” dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”.

Një ditë më parë rreth orës 21:30 F.M. shkoi për mjekim në spitalin rajonal të Elbasanit me një plagë në këmbë, e dyshuar e shkaktuar nga një armë zjarri. Pasi ka marrë mjekim 35-vjeçari ka dalë nga spitali.

Gjatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor, F. M. ka deklaruar se ishte dëmtuar me një hekur, pasi ishte rrëzuar nga motori, në vendin e quajtur “Harqet”.

Policët kanë shoqëruar edhe dy personat e tjerë, shokë të të plagosurit të cilët gjatë marrjes në pyetje nuk kanë treguar rrethanat e vërteta të ngjarjes.

“Shkoi për mjekim në spital, i dëmtuar në këmbë, dyshohet me armë zjarri, dhe nuk tregoi rrethanat e ngjarjes, arrestohet në flagrancë nga Policia. Në pranga edhe 2 shtetas të tjerë (shokët e tij), për moskallëzim krimi. Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Elbasan arrestuan në flagrancë shtetasit: F. M., 35 vjeç, Sh. H., 33 vjeç dhe M. G., 30 vjeç, të tre banues në lagjen “5 Maji”, Elbasan. Më datë 30.12.2022, rreth orës 21:30, ka shkuar për mjekim në spitalin rajonal të Elbasanit, shtetasi F. M., me një plagë në këmbë, e dyshuar e shkaktuar nga një armë zjarri. Pasi ka marrë mjekim, ky shtetas ka dalë nga spitali. Gjatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor, shtetasi F. M. ka deklaruar se ishte dëmtuar me një hekur, pasi ishte rrëzuar nga motori, në vendin e quajtur “Harqet”. Shërbimet e Policisë kanë shoqëruar edhe shtetasit Sh. H. dhe M. G., shokë të shtetasit F. M., të cilët gjatë marrjes në pyetje nuk kanë treguar rrethanat e vërteta të ngjarjes. Grupi hetimor nuk ka gjetur asnjë send të kundraligjshëm, gjatë kontrollit në vendin e ngjarjes të pretenduar nga 35-vjeçari”, sipas policisë.

Nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e personave të përfshirë në këtë ngjarje.

Top Channel

Aktualitet »



Shqiptarët pinë më pak alkool/ Eurostat: Të parafundit në kontinent për konsum pijesh

🕒 02/01 15:01



Mostransparenca online/ Ekspertët: Ndikon në përhapjen e lajmeve të rreme dhe propagandës

🕒 02/01 12:03



Me kallashnikov në punë, arrestohet 24-vjeçari në Vlorë

🕒 02/01 11:05



Arrestohen tre shoferë në Fier/ Njëri përplasi një grua, dy të tjerë u kapën në gjendje të dehur

🕒 02/01 10:43



E zhdukur prej tri ditësh, gjendet në liqenin e Prespës trupi i pajetë i gruas

🕒 02/01 10:13



Virozat e stinës, dhjetëra fëmijë priten natën e ndërrimit të viteve në spital

🕒 02/01 10:03

Kryesore »



Përplaslet helikopteri në Australi, katër persona humbin jetën

🕒 02/01 16:33



Von Der Leyen: BE-ja do qëndrojë pranë Ukrainës për aq kohë sa duhet

🕒 02/01 16:19



Shqiptarët pinë më pak alkool/ Eurostat: Të parafundit në kontinent për konsum pijesh

🕒 02/01 15:01



Zhytje në ujin e ngrirë të Detit të Veriut, holandezët festojnë Vitin e RI!

🕒 02/01 13:33



Ylli i Marvel, Jeremy Renner në gjendje kritike pas aksidentit në borë

🕒 02/01 13:31



Moti në javën e parë të janarit, orë të shumta me diell dhe temperatura të larta

🕒 02/01 12:42

Na ndiqni:

f

Top Channel

📷

@topchannelalbania


🐦

@tchbreakingnews

▶

Top Channel

Video »



Top News – Dubai heq taksën për alkoolin/ Kërkon të bëhet ‘kryeqyteti’ i festave në botë



Top News – Erdogan mund të nisë një luftë!/ Si po përgatitet Turqia për zgjedhjet e 2023




Top News – Aksident në dëborë/ Ylli i Marvel në gjendje kritike për jetën



Top News – 3 shoferë në pranga/ Të dehur në timon, përplaslet këmbësorja



Top News – Festë e përgjakshme në fushëbetejë/ Ukraina- Vramë 400 ushtarë rusë në Donjeck



Top Channel/ Shqiptarët pinë më pak alkool! Eurostat: Të parafundit në kontinent për konsum pijesh

Kryesore



Shqiptarët pinë më pak alkool/ Eurostat: Të parafundit në kontinent për konsum pijesh

🕒 15:01

Kaosi në tregun farmaceutik/ Ndryshimet në ligjet e barnave nuk përputhen me direktivat europiane

🕒 12:08

Mostransparenca online/ Ekspertët: Ndikon në përhapjen e lajmeve të rreme dhe propagandës

🕒 12:03

Suedia, kryesuese e re e BE-së: Në fokus do të kemi Ballkanin!

🕒 11:31

Moti në javën e parë të janarit, orë të shumta me diell dhe temperatura të larta

🕒 12:42

Më të lexuarat

Sara Hoxha dhe Luixhino, fituesit e edicionit të parë të “Dancing With The Stars” në Top Channel

Njeriu më i gjatë në botë/ 29-vjeçari duket se ka rrëmbyer titullin! (foto)

Finalistët e Dancing With The Stars tregojnë arsyet se pse duhet të shpallen ata fitues

“Kthim në kohë”/ Avioni nisët në fluturim në 2023, arrin në...2022-shin

E zhdukur prej tri ditësh, gjendet në liqenin e Prespës trupi i pajetë i gruas

Me kallashnikov në punë, arrestohet 24-vjeçari në Vlorë

Trajneri i Al Nassr: Ronaldo? Do të doja të më sillnin Messin

Le ta sqarojmë njëherë e mirë, ja se kur duhet të hiqet pema e Vitit të RI!

Shok në Veria të Greqisë! Nëna me probleme psikologjike hedh foshnjën 11 muajshe në lumë

Me një performancë plot ndjenjë, Dalina përlotet nga kërcimi i fundit i Elhaidës dhe Ledianit